



KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 31, datë 24.09.2019

**“Për autorizimin e Drejtorit të Përgjithshëm  
për nënshkrimin e marrëveshjes të kujdestarinë së titujve në monedhë të  
huaj me Raiffeisen Bank International AG”**

Në mbështetje të nenit 43, pika 1, shkronja “ll” dhe shkronja “m”, të nenit 52, pika 1, shkronja “i”, të nenit 59, pika 1 dhe pika 4 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave” i ndryshuar, të nenit 72, pika 1 dhe të nenit 42, pika 7 të ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, të nenit 8, shkronja “i”, të nenit 13, pikat 1, 2 dhe 3 dhe të nenit 17, pika 2 të Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 17, datë 28.07.2016 “Mbi miratimin e Rregullores për politikën e administrimit të mjeteve financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të ndryshuar, të Vendimit të Komitetit të Investimeve nr. 8, datë 17.9.2019, të nenit 8, pika 3, shkronja “j” të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave

V E N D O S I:

1. Të autorizojë Drejtorin e Përgjithshëm për nënshkrimin e marrëveshjes të kujdestarinë së titujve në monedhë të huaj me Raiffeisen Bank International AG.
2. Ngarkohet Komiteti i Investimeve, Sektori i Financës dhe Investimeve dhe Sektori i Analizës së Riskut për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

**Sekretar**

Donald Duraj

**Kryetar**